

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklaratat e ambasadores amerikane trazojnë Greqinë, qeveria mohon kërcënimin për rrëzim - Informoh u siç duhet
ADRESA	https://radar.al/deklaratat-e-ambasadores-amerikane-trazojne-greqine-qeveria-mohon-kerce-nimin-per-rrëzim/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:58:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e9dc810a37e354bc61d55bbcadfb6281c73d9a5d6482034bd76a4b8318660794
TEKSTI	2b6387424aea37f205d87522df82bccab9115330f194f4f342255a78e963bc57
PAMJA	d03249f6c25b797394f782bdbe5366e8ef3afd02d1ee938dd5447e81b11ded20

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80aca48b0916db0441775bbf9b95fd3dec384594c6dfa2dcf38658186e33f9a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80aca48b0916db0441775bbf9b95fd3dec384594c6dfa2dcf38658186e33f9a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Deklaratat e ambasadores amerikane trazojnë Greqinë, qeveria mohon kërcënimin për rrëzim

KRYESORE

Demo

Deklaratat e ambasadores amerikane trazojnë Greqinë, qeveria mohon kërcënimin për rrëzim

SEPTEMBER 28, 2026



Një raportim i "Wall Street Journal" ka shkaktuar debat në politikën greke, pasi ambasadorja amerikane në Athinë, Kimberly Guilfoyle, dyshohet se ka deklaruar gjatë një darke me zyrtarë grekë dhe amerikanë se Shtetet e Bashkuara kishin ndikuar në ndryshimin e qeverisë së Rumanisë dhe se mund të bënin të njëjtën gjë edhe në Greqi.

Sipas raportimit, episodi ka ndodhur në mars, gjatë një darke në Athinë, ku Guilfoyle dyshohet se është përplasur në debat me ministrin grek të Energjisë, Stavros Papastavrou. Në atë kohë, diskutimet lidhen me situatën politike në Rumani dhe rënien e pritshme të qeverisë së drejtuar nga Ilie Bolojan.

Sipas personave të cituar nga "Wall Street Journal", Guilfoyle i ka thënë Papastavrou se Shtetet e Bashkuara kishin qenë të përfshira në largimin e qeverisë rumune, ndërsa më pas ka deklaruar: "Ne mund t'ia bëjmë këtë çdo vendi që duam. Mund ta bëjmë edhe këtu".

Papastavrou, sipas të njëjtit raportim, i është përgjigjur se Shtetet e Bashkuara nuk mund ta zëvendësonin qeverinë greke, pasi ajo ishte zgjedhur nga qytetarët. Avokati i Guilfoyle e ka kundërshtuar versionin e bisedës të publikuar nga gazeta amerikane.

Çështja ka shkaktuar reagime të forta nga partitë opozitare greke, të cilat i kanë kërkuar qeverisë së Kyriakos Mitsotakis të japë shpjegime për atë që pretendohet se ka ndodhur gjatë darkës.

PASOK deklaroi se vetëm qeveria dhe veçanërisht ministrinë kompetente të Punëve të Jashtme dhe të Mjedisit e Energjisë kanë autoritetin për të sqaruar raportimin dhe për të verifikuar vërtetësinë e tij. Partia theksoi gjithashtu se Greqia është një demokraci e pavarur dhe sovranë.

Aleanca e së Majtës Greke (ELAS) i cilësoi deklaratat e pretenduara si "të paprecedenta dhe të papranueshme", duke kërkuar që qeveria të sqarojë nëse incidenti ka ndodhur, përse nuk është bërë publik që prej muajit mars dhe nëse ka pasur ndonjë reagim zyrtar.

Edhe SYRIZA e konsideroi raportimin "jashtëzakonisht serioz", duke kërkuar nga qeveria të mos vazhdojë të heshtë. Sipas partisë, nëse deklaratat rezultojnë të sakta, çështja do të kishte pasoja për mënyrën se si vlerësohen marrëdhëniet mes Athinës dhe Uashingtonit.

Ndërkohë, Partia Komuniste e Greqisë (KKE) ka akuzuar qeverinë se mban përgjegjësi dhe e ka lidhur çështjen edhe me vizitën e pritshme në Greqi të Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio. KKE pretendon se vizita lidhet me avancimin e bashkëpunimit strategjik mes dy vendeve.

Në një zhvillim të fundit, qeveria greke ka mohuar se ka pasur ndonjë kërcënim ndaj saj. Zëdhënësi i qeverisë, Pavlos Marinakis, deklaroi se "nuk ka pasur kurrë çështje të kërcënimit të qeverisë greke",

Postimet e reja

MBI 500 MILIONË USD NË PRONA DHE 2 MIJË...

SEPTEMBER 28, 2026

Deklaratat e ambasadores amerikane trazojnë...

SEPTEMBER 28, 2026

Zjarr masiv në kodrat me ullishta në Kreshpan, era...

SEPTEMBER 28, 2026

Vdekja e George Mazonakis, infermierja...

SEPTEMBER 28, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

duke shtuar se një situatë e tillë nuk do të ishte e pranueshme.

Në qendër të debatit është edhe Korridori Vertikal i Gazit, projekt që synon transportimin e gazit përmes Greqisë, Bullgarisë dhe Rumanisë drejt Europës Qendrore dhe Lindore. Guilfoyle është përfshirë në promovimin e këtij projekti dhe të përdorimit të gazit natyror të lëngshëm amerikan në rajon.

Pavarësisht reagimeve politike, pretendimet mbi bisedën në darkën e marsit mbeten të kontestuara, pasi raportimi i "Wall Street Journal" bazohet në dëshmi të personave të pranishëm ose të informuar për episodin, ndërsa avokati i ambasadores ka kundërshtuar përshkrimin e bisedës.

ambasadorja greqi

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.